



**Agjencia Kombëtare e Arsimit, Formimit Profesional dhe Kualifikimeve
Sektori i Profesioneve dhe Kualifikimeve Profesionale**

STANDARDI I KUALIFIKIMIT PROFESIONAL

“SHËRBIME KUJDESI PËR TË MOSHUAR”

Niveli IV në KSHK¹, referuar nivelit IV të KEK²

U-IV-20

Tiranë, 2020

¹ Korniza Shqiptare e Kualifikimeve

² Korniza Evropiane e Kualifikimeve

Emërtimi i kualifikimit	Shërbime kujdesi për të moshuar		Kodi
Kohëzgjatja	3800-4200 orë	Niveli	U-IV-20
		IV në KSHK, referuar nivelit IV të KEK	
Qëllimi:	Qëllimi kryesor i kualifikimit profesional “Shërbime kujdesi për të moshuar”, niveli IV në KSHK (4 vjeçar), referuar nivelit IV të KEK, është “përgatitja e individëve për t’u punësuar si menaxher të mesëm, në veprimtaritë profesionale që lidhen drejtpërdrejt me fushën e shërbimeve sociale dhe shëndetësore dhe zhvillimi i personalitetit të individëve për të jetuar në përshtatje me botën që i rrethon”.		
Kriteret e përgjithshme të pranimit:	<p>Në institucionet e arsimit profesional që ofrojnë kualifikim profesional “Shërbime kujdesi për të moshuar” të nivelit IV në KSHK(4 vjeçar), referuar nivelit IV të KEK, kanë të drejtë të regjistrohen të gjithë individët që:</p> <ul style="list-style-type: none"> – kanë mbaruar arsimin e detyruar 9-vjeçar; – janë në kushte shëndetësore që të përballojnë kërkesat e këtij niveli të arsimit profesional. 		
Mundësitë e kualifikimit të mëtejshëm dhe të punësimit:	<p>Përfundimi me sukses i kualifikimit profesional “Shërbime kujdesi për të moshuar”, niveli IV në KSHK (4 vjeçar), referuar nivelit IV të KEK, e pajis individin me Certifikatën Profesionale dhe Supplementin përkatës që përkon me nivelin profesional teknik/menaxher në këtë fushë profesionale, të njohur në territorin e Republikës së Shqipërisë.</p> <p>Ky arsimim i jep mundësi individit t’i drejtohet tregut të punës në institucione që ofrojnë shërbime sociale/shëndetësore dhe kujdesi për të, moshuar në qendra rezidenciale ose ditore për të moshuar, në shërbimet komunitare të përkujdesjes, në klinikë, spitale, për t’u vetëpunësuar si kujdestar për të moshuar, mbas një përvoje pune, për të krijuar një biznes të vogël në fushën e shërbimeve sociale dhe shëndetësore për të moshuar.</p> <p>Përfundimi me sukses i arsimit profesional në drejtimin “Shërbime kujdesi për të moshuar”, niveli IV në KSHK (4 vjeçar), referuar nivelit IV të KEK, individit fiton të drejtën e Diplomës së Maturës Shtetërore Profesionale. Me përfundimin e këtij niveli, individit ka mundësi për vazhdimin e arsimimit në nivelin pas të mesëm ose në nivelin e studimeve universitare.</p>		
Data e validimit			
Data e miratimit			
Variantet e mëparshme	U-IV-15		

STRUKTURA E KUALIFIKIMIT

Rezultatet e të nxënit në:

NJOHURI

Individi duhet të dijë:

Legjislacioni

- Të përshkruajë legjislacionin e përgjithshëm dhe institucional në gerontologji;
- Të përshkruajë konceptet bazë të legjislacionit të shërbimeve sociale dhe shëndetësore;
- Të përshkruajë qëllimin dhe aspektet e përkujdesjes gerontologjike;
- Të përshkruajë bazat ligjore të higjienës;
- Të përshkruajë disa masa informimi mbi mbrojtjen ligjore për individët në nevojë;
- Të përshkruajë direktivat kryesore të politikës për mbrojtjen e personave të moshuar;

Institucionet

- Të përshkruajë institucionet e shërbimit të kujdesit për të moshuar dhe shërbimet përkatëse të tyre;
- Të përshkruajë organizimin e strukturave të përkujdesjes social-shëndetësore për të moshuar;
- Të përshkruajë shërbimet kryesore sociale dhe mjeko-sociale të një institucioni të kujdesit për të moshuar;
- Të përshkruajë parimet e përgjithshme të komunikimit ndërinstitucional;
- Të përshkruajë mënyrën dhe domosdoshmërinë e komunikimit me institucionet të tjera si, policia, shërbimi shëndetësore, këshilltarët, psikologu apo njerëz të tjerë;

Të drejtat, detyrimet dhe etika profesionale

- Të listojë disa të drejta dhe detyrime të një individi në nevojë në një situatë të dhënë;
- Të përshkruajë të drejtën e individit për shërbime dhe mbështetje;
- Të listojë të drejtat dhe detyrat e punonjësit të shërbimit social për kujdesin që ofron;
- Të shpjegojë domosdoshmërinë e zbatimit të rregullave në lidhje me etikën, konfidencialitetin dhe diskrecionin profesional etj.;
- Të listojë parimet e humanizmit dhe rëndësinë e zbatimit të tyre në punën e përditshme;
- Të shpjegojë domosdoshmërinë e ruajtjes së respektit dhe dinjitetit të individit;
- Të shpjegojë domosdoshmërinë e zbatimit të parimi i autonomisë;
- Të shpjegojë domosdoshmërinë e respektimit të privatësisë gjatë përkujdesjes për individët në nevojë dhe familjarëve të tij;
- Të shpjegojë domosdoshmërinë e informimit të individit në nevojë mbi procedurat e kryera;

- Të shpjegojë konceptin e konfidencialitetit për njerëzit që hyjnë në shërbim, të afërmit dhe profesionistët e tjerë;
- Të shpjegojë rëndësinë e përcaktimit dhe zbatimit të kufijve të konfidencialitetit;
- Të përshkruajë rregullat dhe politikat të konfidencialitetit në procedurat që kryen;
- Të përshkruajë nevojën e informimit të anëtarëve të familjes për të drejtat dhe detyrat e tyre;
- Të përshkruajë disa masa informimi mbi mbrojtjen ligjore për individët në nevojë;
- Të përshkruajë direktivat kryesore të politikës për mbrojtjen e personave të moshuar;
- Të përshkruajë direktivat dhe politikat në lidhje me strukturat dhe organizimin e shërbimeve sociale që ofrohen;

Organizimi i punës

- Të përshkruajë etapat e organizimit të vendit të punës;
- Të shpjegojë rëndësinë e etikës profesionale në shërbimet sociale/shëndetësore;
- Të përshkruajë standardet e shërbimeve social-shëndetësore;
- Të përshkruajë standardet e shërbimeve të kujdesit për të moshuar;
- Të tregojë detyrat e kujdestarit gjatë përdorimit të barnave;
- Të tregojë detyrat e kujdestarit për ruajtjen e kushteve të higjienës dhe ambientit rrethues;
- Të përshkruajë fazat e hartimit dhe zbatimit të planveprimi individual duke respektuar personalitetin e individit të asistuar, duke kërkuar dhe pëlqimin e tij apo të familjarëve;
- Të shpjegojë domosdoshmërinë e respektimit të rregullave të punës në grup, si marrja në dorëzim e turnit dhe dorëzimi i turnit;
- Të shpjegojë rëndësinë e përdorimit të formularëve të miratuar për dokumentimin e punës së kryer;
- Të përshkruajë mënyrën e vendosjes së përparësive dhe prioriteteve në një situatë të dhënë, duke pasur parasysh aftësitë e individit, mjedisin, burimet, kufizimet, etj.;
- Të përshkruajë rëndësinë e ndarjes dhe caktimit të detyrave gjatë punës në grup;
- Të shpjegojë rëndësinë dhe mënyrat e raportimit;
- Të përshkruajë mënyrën e vlerësimit të boshllëqeve të një individi për të përcaktuar shkaqet e reagimeve dhe të përgjigjeve të tij;
- Të shpjegojë rëndësinë e përfshirjes së të moshuarve në marrjen e vendimeve, rreth aktiviteteve të ndryshme të jetesës së tyre;
- Të listojë masat për mbrojtjen e shëndetit personal sipas protokolleve shëndetësore për individët që ofrojnë kujdes shëndetësor;
- Të shpjegojë mënyrën e realizimit të shërbimeve në banesë në distancë, për parandalimin e përhapjes së infeksioneve;
- Të identifikojë nevojat për mbështetje të familjeve dhe të tjerëve të prekur drejtpërdrejtë në situata pandemie;

Individi dhe familja

- Të shpjegojë rëndësinë e respektit për individët në nevojë pavarësisht moshës, gjinisë, besimit fetar dhe përkatësisë racore;
- Të përshkruajë diversitetin e qenies njerëzore dhe rëndësinë e respektimit të tij;
- Të listojë karakteristikat e një kujdestari për të moshuar;
- Të përshkruajë mënyrën e sjelljes ndaj klientit për shërbimet e kërkuara;
- Të tregojë si veprohet në rast pamundësie të ofrimit të shërbimit të kërkuar;
- Të përshkruajë mënyrën e sjelljes profesionale në familjet me probleme ndaj familjarëve dhe individit të cilit i ofrohet shërbimi;
- Të përshkruajë qëllimin dhe rëndësinë e studimit psiko-pedagogjik të njeriut sipas grupmoshave;
- Të përshkruajë mënyrën e sjelljes profesionale ndaj të moshuarve me probleme vartësish nga substanca të ndryshme si duhani, alkooli;
- Të përshkruajë bazat e zhvillimit biologjik të individit në stade të ndryshme zhvillimi;
- Të identifikojë ndryshimet e njeriut gjatë fazave të ndryshme të zhvillimit;
- Të përshkruajë zhvillimin psikologjik në moshat e hershme;
- Të përshkruajë zhvillimin psikologjik në moshat e rritura;
- Të përshkruajë problemet psikologjike që shfaqen në moshën e tretë;
- Të shpjegojë deficitet fiziko-motore që shfaqen në moshën e tretë;
- Të përshkruajë çrregullimet biologjike që mund të shfaqen në fazat e ndryshme të zhvillimit të individit;
- Të përshkruajë problemet e sjelljes që mund të takohen në çdo fazë të zhvillimit të individit;
- Të identifikojë faktorët që mund të ndikojnë në sjelljen e individit;
- Të përshkruajë zhvillimin fizik të individit që në fëmijëri;
- Të përshkruajë aspekte të ndryshimit të gjendjes fizike të të moshuarve;
- Të listojë ndryshimet e zhvillimit fizik të të moshuarve me aftësi ndryshe dhe atyre me nevoja të veçanta;
- Të listojë karakteristikat e integritetit social të të moshuarit;
- Të përshkruajë problemet sociale që shfaqen tek të moshuarit;
- Të listojë karakteristikat e zhvillimit social në fëmijëri;
- Të përshkruajë zhvillimin biologjik të individit në adoleshencë;
- Të shpjegojë fazën e pubertetit dhe mënyrat e përjetimit të tij nga individët e kësaj moshe;
- Të përshkruajë zhvillimet sociale dhe problemet që shfaqen në adoleshencë;
- Të përshkruajë karakteristikat e marrëdhënieve njerëzore në moshën e rinisë

dhe moshën e mesme;

- Të përshkruajë karakteristikat dhe format e socializimit të të moshuarve;
- Të përshkruajë rëndësinë e historikut të jetës së të moshuarit;
- Të përshkruajë aspektet sociale dhe nevojat e individëve të moshës së tretë;
- Të përshkruajë disa nga sëmundjet më të shpeshta të moshës së tretë;
- Të listojë disa nga problemet dhe sjelljet që mund të hasen gjatë shërbimit të të moshuarve dhe faktorët që ndikojnë;
- Të përshkruajë disa nga shërbimet e nevojshme për individët e kësaj moshe;
- Të përshkruajë rëndësinë e mbështetjes së familjarëve të pacientëve që janë në prag të vdekjes;
- Të përshkruajë mbështetjen që ofrohet për individët me sëmundje të rënda dhe për ata që janë në prag të vdekjes;

Komunikimi

- Të shpjegojë komunikimin dhe rëndësinë e tij;
- Të listojë llojet e komunikimit;
- Të përcaktojë llojin e komunikimit sipas mjedisit përkatës dhe veçorive individuale;
- Të përshkruajë pengesat në procesin e komunikimit;
- Të përshkruajë rregullat e komunikimit me familjet ku punon;
- Të përshkruajë rregullat e komunikimit me kolegët dhe eprorët;
- Të tregojë bazat e një komunikimi të përshtatshëm me individin sipas moshës së tij dhe sipas aftësive komunikuese;
- Të përshkruajë mënyrën e komunikimit me familjarët për situatat e vështira shëndetësore të sjelljes apo raste ekstreme të të afërmit të tyre;
- Të përshkruajë mënyrën e komunikimit të lajmeve të papritura me të moshuarin;
- Të dallojnë mesazhet e pashkruara dhe vizuale dhe gjuhën e trupit;
- Të shpjegojë komunikimin verbal dhe atë jo-verbal;
- Të shpjegojë rëndësinë e komunikimit jo-verbal në identifikimin e sëmundjeve psikologjike dhe mendore;
- Të përshkruajë rëndësinë e hartimit të dokumenteve shkresore sipas formateve të institucioneve të ndryshme;
- Të shpjegojë mënyrën e plotësimit të formateve të miratuara për dokumentimin e punës së kryer;
- Të dallojë mjetet dhe format e komunikimit masiv;
- Të përshkruajë mënyrën e komunikimit me grupet në nevojë;
- Të shpjegojë komunikimin personal dhe ndër-personal;
- Të shpjegojë komunikimin ndërkulturor dhe social;
- Të shpjegojë rëndësinë e përdorimit të teknologjisë nga të moshuarit si mjet komunikimi me familjarët që janë larg;
- Të shpjegojë rëndësinë e komunikimit si faktor motivues për moshat e treta;

Përkujdesjesi social-shëndetësore

- Të përshkruajë historikun dhe qëllimet e përkujdesjes social-shëndetësore për të moshuar;
- Të përshkruajë përbërjen dhe funksionet e ekipit të përkujdesjes social-shëndetësore për të moshuar;
- Të përshkruajë etapat e përkujdesjes social-shëndetësore për të moshuar;
- Të përshkruajë rolet dhe përgjegjësitë e ekipit të përkujdesjes social-shëndetësore;
- Të përshkruajë dallimin e të përkujdesjes dhe masave shëruese;
- Të shpjegojë format e kontrollit të efikasitetit të përkujdesjes së ofruar;
- Të përshkruajë metodën e duhur të komunikimit me individin e asistuar për të kuptuar nevojat e tij;
- Të përshkruajë metodat e intervistimit, dëgjimin dhe vëzhgimin duke pasur parasysh moshën e dhe gjendjen fizike të individit të asistuar;
- Të shpjegojë mënyrën e prezantimit të shërbimit të klienti i moshuar;
- Të shpjegojë rëndësinë e përdorimit të barnave bazuar në rekomandimin e mjekut;

Edukim shëndetësor dhe higjiena

- Të listojë rrugët e përhapjes së infeksioneve;
- Të përshkruajë llojet e infeksioneve;
- Të shpjegojë mënyrat e parandalimit të sëmundjeve infektive;
- Të shpjegojë asepsinë dhe rregullat aseptike;
- Të përshkruajë larjen kirurgjikale të duarve;
- Të përshkruajë rëndësinë e larjes së duarve në parandalimin e infeksioneve;
- Të listojë disa nga sëmundjet infektive më të shfaqura në moshën e tretë;
- Të listojë disa nga simptomat që të moshuarit shfaqin nga sëmundjet infektive;
- Të listojë pasojat në shëndetin e të moshuarit për shkak të sëmundjeve infektive;
- Të përshkruajë si bëhet kontrolli i sëmundjeve infektive;
- Të përshkruajë programin ditor për ruajtjen dhe mbajtjen e higjienës personale të të moshuarit;
- Të përshkruajë format e ruajtjes së higjienës së ambientit rrethues;
- Të përshkruajë metodat e izolimi dhe rëndësinë e tij në rast sëmundjesh infektive të të moshuarit;
- Të përshkruajë formën e kujdesit për një të moshuar me sëmundje infektive;
- Të listojë pajisjet dhe veshjet e posaçme të punës kur kujdeset për një të moshuar me sëmundje infektive;
- Të përshkruajë format e trajtimit të produkteve apo mjeteve që përdoren nga i moshuari me sëmundje infektive;
- Të listojë rregullat që duhen zbatuar kur ofrohet kujdes ndaj një individi me sëmundje infektive;
- Të shpjegojë format e shmangies së infeksioneve të kryqëzuara mes të moshuarve;

- Të sqarojnë metodat fizike të dezinfektimit edhe sterilizimit;
- Të përshkruajë fazat e sterilizimit;
- Të përshkruajë si bëhet dezinfektimi me anë të substancave kimike;
- Të shpjegojë rëndësinë e ndërgjegjësimit të të moshuarit për ruajtjen e higjienës personale;
- Të shpjegojë rëndësinë e ndërgjegjësimit të të moshuarit për respektimin e këshillave nga mjeku për probleme të ndryshme të shëndetit.

Barnat mjekësore

- Të përshkruajë llojet e barnave kryesore të ndihmës së parë;
- Të tregojë format farmaceutike të barnave;
- Të listojë rregullat e kujdesit në përdorimin e barnave;
- Të listojë rrugët e marrjes së barnave;
- Të përshkruajë “ 5 rregullat D”;
- Të përshkruajë mënyrën e shpërndarjes së barnave në organizëm;
- Të shpjegojë metabolizmin e barnave në organizëm;
- Të tregojë rrugët e eliminimit të barnave në organizëm;
- Të listojë faktorët që ndikojnë mbi efektin e barnave;
- Të tregojë si bëhet këshillimi/instruktimi i të moshuarve, të moshuarve në nevojë dhe familjarëve të tyre në lidhje me barnat;
- Të listojë barnat me efekt në qarkullimin e gjakut dhe zemër;
- Të listojë barnat me efekt në traktin e frymëmarrjes;
- Të listojë barnat me efekt traktin tretjes;
- Të listojë barnat me efekt tek syri dhe veshi;
- Të listojë barnat me efekt tek sistemi nervor;
- Të listojë barnat psikiatrike;
- Të listojë barnat për sistemin hormonal;
- Të përshkruajë kimoterapinë;
- Të përshkruajë alergjinë medikamentoze dhe efektet e padëshiruara;
- Të përshkruajë metodat e diagnostikimit të situatës, për të vlerësuar potencialin e individit, si dhe disavantazhet e tij, të metat dhe paaftësitë;
- Të shpjegojë rëndësinë e menaxhimit të dhimbjes;
- Të përshkruajë format e ndjekjes në dinamikë të gjendjes shëndetësore të të moshuarit;
- Të përshkruajë rëndësinë e monitorimeve periodike të parametrave vitalë të të moshuarit;
- Të përshkruajë formatet e dokumentimit të monitorimit të shëndetit të të moshuarit;
- Të përshkruajë mënyrën e raportimit të problematikave shëndetësore që paraqiten gjatë ofrimit të kujdesit;

Vlerësimi Social

- Të shpjegojë ç' është ndërhyrja sociale;
- Të karakterizojë nga pikëpamja sociale mjedisin ku jeton dhe punon;
- Të shpjegojë nocionin e mirëqenies sociale;
- Të shpjegojë rregullat dhe etikën e sjelljes në shoqëri;
- Të dallojë individët dhe grupet në nevojë;
- Të listojë problematikat sociale më të shprehura;
- Të përshkruajë mënyrat e ndërhyrjes sociale në komunitet, familje dhe individë dhe vendosjen e marrëdhënieve me individë dhe grupe;
- Të identifikojë një sjellje devijante dhe të tregojë mënyrat e evitimit të tyre;
- Të dallojnë sjelljet paragjykuese dhe të tregojë mënyrat e evitimit të tyre;
- Të listojë llojet e diskriminimit;
- Të dallojnë rastet e diskriminimit dhe të tregojë mënyrat e evitimit të tyre;
- Të dallojnë situatat konfliktuale dhe burimin e tyre;
- Të tregojë format e parandalimit të situatave konfliktuale;
- Të tregojë si bëhet vlerësimi dhe vetëvlerësimi;
- Të shpjegojë rëndësinë e motivimit dhe vetë-motivimit;
- Të përshkruajë fazat e evolucionit sociologjik të familjes;
- Të përshkruajë fazat e evolucionit sociologjik të individit.
- Të përshkruajë rëndësinë e marrëdhënieve familjare, duke përfshirë marrëdhëniet dhe konfliktet midis brezave dhe mënyrën e zgjidhjes së tyre (çështje personale dhe të partneritetit);
- Të përshkruajë ndryshimet psiko-sociale, paaftësinë, moshimin në jetën e një individi;
- Të shpjegojë nevojën e socializimit dhe përfshirjes në jetën shoqërore të një individi dhe dimensionet e ndryshme të qasjes;
- Të listojë disa situata të sjelljes midis një individi me aftësi ndryshe dhe familjes;
- Të listojë disa situata të sjelljes midis një individi me vartësi nga alkooli dhe familjes;
- Të përshkruajë mënyrën e vlerësimit të situatës dhe nevojave të individit të asistuar;
- Të përshkruajë metoda të analizës së informacionit të mbledhur dhe vendosjes së prioritetëve;
- Të përshkruajë rëndësinë e aktiviteteve sociale në gjendjen psikologjike të të moshuarve;
- Të rendisë format e aktiviteteve sociale për të moshuar ;
- Të përshkruajë rëndësinë e realizimit të seancave psikologjike për të moshuarit me qëllim parandalimin e sëmundjeve depresive;
- Të përshkruajë nevojën e rishikimit të planveprimi individual në përputhje me rrethanat e reja për të përgatitur një ndërhyrje të mëvonshme;

Punë në grup

- Të përshkruajë teknikat e organizimit dhe lehtësimit të grupit;
- Të përshkruajë teknikat e mobilizimit dhe veprimi në grup;

- Të përshkruajë teknikat e vlerësimit të një veprimi kolektiv;
- Të përshkruajë nevojën dhe metodat e aktualizimit të njohurive;
- Të listojë disa argumente të nevojës së punës në grup;
- Të shpjegojë mënyrën e marrjes së vendimeve në një situatë të dhënë;
- Të shpjegojë mënyrën e të intervistuarit të individit për problemet sociale që shfaq;
- Të përshkruajë mënyrat e nxitjes së shprehjes/komunikimit duke përdorur teknikat e komunikimit për të ndihmuar personin në nevojë;
- Të identifikojë modelet e komunikimit në marrëdhëniet familjare, të gjeneratave të ndryshme dhe marrëdhëniet ndërkulturore;
- Të identifikojë metodat për gjithëpërfshirjen e individëve në aktivitet;
- Të përshkruajë rëndësinë e njohjes së heterogjenitetit motivues dhe emocional të individëve.
- Të identifikojë situatat e rrezikshme gjatë një aktiviteti social;
- Të përshkruajë përdorimin e teknikave të menaxhimit të konflikteve dhe situatave të vështira;
- Të listojë parimet e ndërhyrjes në menaxhimin e konflikteve;

Dokumentacion dhe TIK (Teknologji e Informacionit dhe Komunikimit).

- Të përshkruajë mënyrën dhe nevojën dokumentimit dhe raportimit të shkruar dhe gojor sipas rastit të dhënë;
- Të përshkruajë mënyrën e formulimit të propozimeve dhe argumentimin e tyre;
- Të përshkruajë mënyrën e trajtimit dhe të ruajtjes së informacionit;
- Të përshkruajë rëndësinë e përdorimit të teknologjisë së informacionit dhe komunikimit në shërbimin e kujdesit për të moshuar;
- Të përshkruajë programin (softuerë) e planifikimit të kujdesit në shërbimin e kujdesit për të moshuar;
- Të përshkruajë programin (softuerë) e dokumentimit të kujdesit në shërbimin e kujdesit për të moshuar;
- Të përshkruajë programin (softuerë) e regjistrimit dhe raportimit të rezultateve të kujdesit për të moshuar;
- Të përshkruajë programin (softuerë) e planifikimit të kohës së shërbimit, pozicionit dhe vendeve të punës së personelit në shërbimin e kujdesit për të moshuar;
- Të përshkruajë programin (softuerë) e të dhënave sociale dhe shëndetësore të të moshuarve;
- Të përshkruajë programin (softuerë) e administrimit ekonomik të të moshuarve;
- Të përshkruajë ruajtjen dhe sigurimin e të dhënave në shërbimin e kujdesit për të moshuar;
- Të tregojë aksesin në network-un e shërbimit të kujdesit për të moshuar;
- Të përshkruajnë problemet gjatë përdorimit të teknologjisë së informacionit dhe komunikimit në shërbimin e kujdesit për të moshuar;

- Të përshkruajë programe ose aplikacione që ndihmojnë në kujdesin shëndetësor të ofruar;

Shërbime kujdesi në aktivitete të jetës së përditshme

- Të përcaktojë metodologjinë e duhur për zhvillimin e plan veprimit individual sipas gjendjes së të moshuarit;
- Të përshkruajë aktivitetet kryesore të jetës së përditshme;
- Të listojë veprimet kryesore të kryera për të bërë blerjet ushqimore të nevojshme dhe nevojën e këshillimit për blerjet e përditshme;
- Të përshkruajë mënyrën e hartimit të menyve në përputhje me bilancin ushqyes, të kulturave dhe mënyrave të jetesës, moshës ose gjendjes shëndetësore;
- Të përshkruajë rëndësinë e ushqyerjes së duhur sipas nevojave të të moshuarit;
- Të përshkruajë mënyrën e ruajtjes dhe mirëmbajtjes së veshjeve apo aksesorëve të tjerë të nevojshëm;
- Të përshkruajë rëndësinë e mjedisin për të siguruar shërbimin e duhur sipas nevojave;
- Të përshkruajë mjetet ndihmëse dhe përdorimin e tyre;
- Të përshkruajë konceptin higjienë dhe rëndësinë e saj;
- Të interpretojnë detyrat e grupeve profesionale të higjienës;
- Të interpretojë politikat për ruajtjen e higjienës;
- Të listojë standardet e higjienës;
- Të listojë protokollat e kontrollit të higjienës;
- Të përshkruajë rëndësinë e përmbytjes së porosive dhe udhëzimet mjekësore;
- Të identifikojë disa nga sëmundjet infektive më të shpeshta sipas shenjave përkatëse të tyre;
- Të tregojë si bëhet pastrimi dhe dezinfektimi i sipërfaqeve dhe ambienteve;
- Të tregojë mënyrën e trajtimit të materialeve apo produkteve të përdorura gjatë ofrimit të kujdesit;
- Të listojë masat parandaluese për sigurinë e personave të asistuar;
- Të listojë burime të paaftësisë dhe masat parandaluese;
- Të përshkruajë mënyrën e administrimit dhe zhvillimit të hapësirës për hir të komoditetit dhe sigurisë;
- Të përshkruajë rastet dhe mënyrën e ndihmës praktike për lëvizjen e të moshuarve me aftësi ndryshe;
- Të përshkruajë metodat e transportimit të moshuarit të imobilizuar nga shtrati në karroce dhe nga karroca në shtrat;
- Të përshkruajë rëndësinë e përdorimit të dyshekut dhe jastekeve antidekubitues tek të moshuarit e imobilizuar;
- Të shpjegojë rëndësinë e inkurajimit të të moshuarit për vetë përkujdesje;
- Të listojë metoda të mobilizimit të potencialit të të moshuarit dhe të sjelljeve të tij;
- Të përshkruajë një ndërhyrje edukative duke përdorur metoda dhe teknikat të

përshtatshme;

- Të shpjegojë nevojën e përshtatjes/integrimit të individit me mjedisin ku jeton dhe përvetësimin e akteve dhe veprimeve të jetës së përditshme;
- Të propozojë zgjidhje për përmirësimin dhe pajisjen e mjedisit ose riorganizimin e tij në funksion të aktivitetit që do të kryhet;
- Të shpjegojë domosdoshmërinë e aktivizimit të aftësive profesionale apo argëtuese të individit në nevojë (p.sh pikturë, skulpturë, apo zeje të ndryshme);
- Të shpjegojë domosdoshmërinë e përdorimit të mjeteve dhe medias për marrjen e informacioneve ditore;
- Të shpjegojë rëndësinë e orientimit në kohë dhe në hapësirë të të moshuarit;
- Të shpjegojë nevojën e mbështetjes dhe lehtësimit të vuajtjes në momentet e fundit të jetës së të moshuarit;
- Të përshkruajë formën e vlerësimit të rezultateve të ofrimit të kujdesit shëndetësor.
- Të përshkruajë kujdesin për një të moshuar paliativ;
- Të përshkruajë kujdesin për trupin e të moshuarit në rast humbje të jetës;
- Të shpjegojë nevojën e mbështetjes së anëtarëve të tjerë të familjes në periudhën para ose pas vdekjes së një anëtari të saj;
- Të përshkruajë formën e dhënies së lajmit familjarëve në rastin e humbjes së jetës të të moshuarit;
- Të përshkruajë nevojën e informimit të anëtarëve të familjes për të drejtat dhe detyrat e tyre;

Përkujdesja shëndetësore dhe mjekësore

- Të përshkruajë anatominë dhe fiziologjinë e trupit të njeriut: të organeve shqisore, sistemet nervor, muskular, skeletik, të qarkullimit të gjakut, të frymëmarrjes, urogenital, degjistik, endokrine;
- Të përshkruajë anatominë dhe fiziologjinë e lëkurës dhe mukozës;
- Të përshkruajë disa situata patologjike dhe pasojat mbi gjendjen klinike të sëmundjes së personit: sëmundje akute, sëmundje kronike, situatat emergjente, situata të fundit të jetës, shprehje të dhimbjeve dhe vuajtjeve;
- Të shpjegojë konceptin e sëmundjeve dhe lidhjen ndërmjet shëndetit dhe sëmundjes;
- Të listojë disa sëmundje somatike dhe sëmundje mendore;
- Të shpjegojë proceset patologjike të një situatë sëmundjeje duke listuar shenjat paralajmëruese, shenjat klinike, ngjyra e lëkurës, të vjella, urinim, ndryshimi i gjendjes;
- Të listojë shenjat e sjelljes gjatë një dhimbjeje dhe mënyrën të vlerësimit drejt të shkallës së saj;
- Të listojë forma të menaxhimit të dhimbjes;
- Të listojë teknikat dhe mjetet e vlerësimit të një ndryshim të papritur në sjelljen;
- Të listojë disa shenjat psikologjike dhe të sjelljes: identifikimi, të kuptuarit, elementet të predisponibilitetit të sjelljes;

- Të listojë disa shenjat të depresionit; ankthit, apatisë, impulsivitet, nervozizmit, agresioni;
- Të listojë disa çrregullime të shëndetit; çrregullime të vëmendjes, disorientim në kohë dhe hapësirë, çrregullime të gjykimit, arsytimit, çrregullime në të folur, çrregullime të lëvizjeve, të gjumit, oreksit, funksioneve njohëse dhe masat që duhen marrë për rastet përkatëse;
- Të listojë sëmundjet më të shpeshta në moshat e treta;
- Të përshkruajë simptomat kryesore në rastet e sëmundjeve kardiovaskulare dhe masat përkatëse që duhen marrë për raste emergjente;
- Të listojë shenjat kryesore në raste të çrregullimeve të tensionit të gjakut masat që duhen marrë sipas rastit;
- Të listojë shenjat kryesore në raste të çrregullimeve të ritmit të zemrës masat që duhen marrë sipas rastit;
- Të shpjegojë rëndësinë e vëzhgimit dhe evidentimit të normave të frekuencës kardiake dhe tensionit arterial;
- Të përshkruajë metodat e matjes së tensionit arterial;
- Të përshkruajë metodat e matjes së pulsit;
- Të shpjegojë rëndësinë e sensibilizimit të të moshuarve mbi mënyrën e jetesës dhe ushqyerjen si faktor parandalimi të sëmundjeve kardiovaskulare;
- Të përshkruajë simptomat kryesore në rastet e sëmundjeve neurologjiko-psikiatrike dhe masat përkatëse që duhen marrë për rastet e rënduara;
- Të përshkruajë simptomat kryesore në rastet e sëmundjeve të mushkërive dhe rrugëve të frymëmarrjes dhe masat përkatëse që duhen marrë për raste emergjente;
- Të përshkruajë metodat e matjes së frekuencës respiratore;
- Të rendisë çrregullimet e frymëmarrjes;
- Të shpjegojë format e çrregullimeve të frymëmarrjes (dispne, apne, polipne, ortopne etj.);
- Të përshkruajë simptomat kryesore në rastet e sëmundjeve të aparatit muskuloskeletik dhe masat përkatëse që duhen marrë për raste emergjente;
- Të listojë sëmundjet më të shpeshta muskuloskeletike që prekin të moshuarit;
- Të shpjegojë rëndësinë e aktiviteteve fizike për të moshuarit me sëmundje muskuloskeletike;
- Të shpjegojë metodat rehabilituese për të moshuarit me sëmundjet muskuloskeletike;
- Të përshkruajë simptomat kryesore në rastet e sëmundjeve të aparatit të tretjes dhe masat përkatëse që duhen marrë për raste emergjente;
- Të listojë sëmundjet që prekin aparatit të tretjes;
- Të shpjegojë rëndësinë e zbatimit të dietës ushqimore që përcakton mjeku për të moshuarit me sëmundje në aparatit të tretjes;
- Të përshkruajë simptomat kryesore në rastet e sëmundjeve onkologjike dhe masat përkatëse që duhen marrë për raste emergjente;

- Të përshkruajë simptomat kryesore në rastet e sëmundjet hormonale dhe masat përkatëse që duhen marrë për raste emergjente;
- Të listojë sëmundjet më të shpeshta hormonale;
- Të identifikojë shenjat e diabetit;
- Të përshkruajë termat poliuri, polifagi, polidipsi;
- Të përshkruajë trajtimin e diabetit;
- Të përshkruajë mënyrën e matjes së glicemisë;
- Të përshkruajë mënyrën e injektimit të insulinës;
- Të identifikojë simptomat e komës diabetike;
- Të përshkruajë simptomat kryesore në rastet e sëmundjeve të aparatit urogenital dhe masat përkatëse që duhen marrë për raste emergjente;
- Të përshkruajë simptomat kryesore në rastet e sëmundjeve infektive dhe masat përkatëse që duhen marrë për raste emergjente;
- Të përshkruajë simptomat kryesore në rastet e sëmundjeve të lëkurës dhe masat përkatëse që duhen marrë për raste emergjente;
- Të listojë rregullat kryesore që duhet të monitorohen gjatë marrjes së një mjekimi (barnash);
- Të përshkruajë formën e matjes së parametrave vitalë.
- Të listojë disa nga çrregullimet që mund të ndodhin gjatë marrjes së medikamenteve dhe veprimet që duhen ndërmarrë në rastet e emergjencës;
- Të listojë shenjat në raste të hipertermisë apo hipotermisë dhe të përshkruajë veprimet emergjente/ të domosdoshme në rregullimin e temperaturës;
- Të listojë shenjat kryesore në raste të çrregullimeve të frekuencës respiratore dhe masat që duhen marrë sipas rastit;
- Të përshkruajë si bëhet matja dhe vlerësimi i oksimetrisë (saturimi i oksigjenit në gjak)
- Të rendisë hapat që duhet të ndërmarrë për përgatitjen, ruajtjen dhe sigurimin e një të moshuari gjatë një vizite mjekësore, analize apo ndërhyrje kirurgjikale;
- Të rendisë hapat që ndiqen në rast se një i moshuar duhet të izolohet për arsye sëmundjeje infektive.
- Të përshkruajë veprimet që duhet të kryejë gjatë monitorimit të një të moshuari të sëmurë që është duke marrë një serum, një mjekim tjetër apo që ka bërë një ndërhyrje kirurgjikale;
- Të përshkruajë veprimet që duhet të kryejë gjatë monitorimit të një të moshuari që është duke marrë një infuzion, oksigjen ose që është duke përdorur pajisje të tjera mjekësore;
- Të listojë disa nga pajisjet apo mjetet që do të përdoren duke ndihmuar mjekun apo infermierin për një proces konkret që do të kryhet (garzë, produktet ...);
- Të përshkruajë mënyrën e përgatitjes dhe instalimit të një aparati aerosol;
- Të listojë llojet e kateterëve;

- Të përshkruajë mënyrën e vendosjes së kateterit;
- Të listojë disa nga rastet emergjente te personat e moshuar dhe mënyrën e veprimeve që duhen ndërmarrë sipas rastit;
- Të listojë disa nga rastet e kujdesit paliativ dhe nevojat e tyre specifike.
- Të përshkruajë hapat në kujdesin e një shërbimi funeral në institucionet shëndetësore;
- Të listojë disa nga parazitët/dëmtuesit (parazitë, pash. morra, etj.) dhe masat që duhen ndërmarrë për të luftuar kundër tyre;
- Të përshkruajë disa mënyra të pastrimit dhe dezinfektimit të materialeve të ndryshme që lidhen me higjienën;

Sipërmarrja dhe edukim karriere

- Të shpjegojë rolin e sipërmarrjes sociale dhe ekonomike në krijimin e një shoqërie të qëndrueshme;
- Të vleftësojë mendime mbi çështje etike që lidhen me veprimtari të ndryshme ekonomike;
- Të përshkruajë fazat e zhvillimit të biznesit në kontekstin e globalizimit;
- Të analizojë format e ndryshme të sipërmarrjes në lidhje me synimet kryesore të karrierës personale, mundësitë dhe përfitimet në komunitet;
- Të shpjegojë konceptet financiare (dokumentet financiare, institucionet financiare..);
- Të listojë komponentët e hartimit të një buxheti;
- Të përshkruajë fazat e manaxhimit të një projekti (duke identifikuar burimet e nevojshme për një projekt të veçantë);
- Të ekzaminojë teknika mbështetëse për të manaxhuar dhe zbatuar një projekt në situata të ndryshme (Analiza SWOT, diagrama e GANT...);
- Të evidentojë mundësitë që ofron tregu i punës dhe kualifikimet e mëtejshme;
- Të përshkruajë konceptin e ndërmarrjeve me përgjegjësi sociale në kontekste lokale dhe globale;
- Të analizojë interesat, zotësitë dhe aftësitë personale përmes mënyrave të ndryshme përfshirë vetëvlerësimin;
- Të analizojë me objektivitet kërkesë-ofertat e tregut për shërbime social-shëndetësore.

Siguria në punë dhe mbrojtja e mjedisit

- Të shpjegojë rëndësinë e ruajtjes së mjedisit si mënyrë jetese në komunitet;
- Të shpjegojë faktorët ndikues në ndotjen e ambientit;
- Të listojë kërkesat e legjislacionit për mbrojtjen e ambientit;
- Të listojë llojet dhe emërtesat e mbetjeve urbane apo spitalore;
- Të dallojë ndryshimet mes mbetjeve organike dhe inorganike;
- Të shpjegojë format e mbrojtjes ndaj mbetjeve të kontaminuara me lëndë kimike apo biologjike dhe trajtimin e tyre;
- Të përshkruajë protokollet kryesore për trajtimin e mbetjeve spitalore ose urbane;
- Të shpjegojë rëndësinë e ndarjes së mbetjeve në burim sipas informacioneve të

dhëna;

- Të shpjegojë rëndësinë e përdorimit të detergjenteve ose lëndë dezinfektuesve të duhura për ambientin ku zhvillojnë aktivitetin e tyre ditor;
- Të përshkruajë disa mënyra të pastrimit dhe dezinfektimit të materiale të ndryshme që lidhen me higjienën;
- Të përshkruajë disa mënyra të pastrimit dhe dezinfektimit të materiale të ndryshme që lidhen me higjienën;

SHPREHI PROFESIONALE

Nxënësi duhet të jetë i aftë:

Organizimi i përkujdesjes për të moshuar

- Të zbatojë etapat e organizimit të vendit të punës;
- Të mirëmbajë pajisjet dhe materialet specifike sipas vendeve përkatëse;
- Të përshtatë mjedisin për të siguruar shërbimin e duhur sipas nevojave;
- Të zbatojë etikën profesionale të kujdestarit për të moshuar;
- Të zbatojë hierarkinë dhe etikën profesionale me kolegët e institucionit të kujdesit.
- Të zbatojë ligjshmërinë përkatëse të shërbimit social-shëndetësor sipas kategorive;
- Të krijojë marrëdhënie profesionale me familjarët e të moshuarve në nevojë social-shëndetësore;
- Të zbatojë fazat e hartimit dhe zbatimit të planveprimi individual duke respektuar personalitetin e individit të asistuar, duke kërkuar dhe pëlqimin e tij apo të familjarëve;
- Të respektojë rregullat e punës në grup, si marrja në dorëzim e turnit dhe dorëzimi i turnit;
- Të vendosë përparësi dhe prioritetë në një situatë të dhënë, duke pasur parasysh aftësitë e individit, mjedisin, burimet, kufizimet, etj.;
- Të ndajë dhe zbatojë detyrat gjatë punës në grup;
- Të zbatojë mënyrat dhe format e duhura të raportimit;
- Të zbatojë masat për parandalimin e infeksioneve;
- Të zbatojë masat për ruajtjen e higjienës personale dhe të individëve që u ofrohet kujdesi;
- Të kryejë matjen e shenjave jetësore të organizmit të të moshuarit në nevojë social-shëndetësore;
- Të zbatojë rekomandimet e mjekut;
- Të zbatojë udhëzimet për dietën e përcaktuar sipas rastit.
- Të reagojë në situata të sjelljeve devijante;
- Të reagojë në situata ku bëhet prezent abuzimi.
- Të prezantojë në formë verbale dhe vizuale vetveten në qendrën që ofron shërbim;
- Të bashkëbisedojë me stafin e qendrës mbi punën e përditshme;

- Të referojë me shkrim për rastet/ situatat/ shërbimet që jepen në qendër;
- Të plotësojë materiale shkresore sipas formateve të institucioneve të ndryshme;
- Të mbështesë stafin e qendrës kur i kërkohet për kryerjen e shërbimeve të ndryshme;
- Të referojë në momentin e duhur çdo problematikë të lindur gjatë punës;
- Të bëjë vlerësimin e punës së kryer.
- Të përfshijë të moshuarit në marrjen e vendimeve, rreth aktiviteteve të ndryshme të jetesës së tyre;
- Të planifikojë një proces të përkujdesjes geriartrike;
- Të dokumentojë dhe analizojë procesin e përkujdesjes geriartrike
- Të planifikojë një proces të përkujdesjes paliative;
- Të dokumentojë dhe të analizojë procesin e menaxhimit të dhimbjes;
- Të zbatojë etikën profesionale të kujdestarit për të moshuar;
- Të zbatojë ligjshmërinë përkatëse të shërbimit social-shëndetësor për të moshuar;
- Të shoqërojë dhe kujdeset për të moshuarin në aktivitetet e jetës së përditshme;
- Të bashkëbisedojë periodikisht me të moshuarin për evidentimin e problemeve të pa referuara nga vetë ata;
- Të zbatojë procedurat e duhura në realizimin e shërbimeve në banesë në distancë, për parandalimin e përhapjes së infeksioneve;
- Të zbatojë protokollet e duhura në situata pandemie;

Të drejtat, detyrimet dhe etika profesionale

- Të respektojë rregullat e etikës, konfidencialitetin dhe diskrecionin profesional.
- Të zbatojë parimet e humanizmit në jetën e përditshme;
- Të informojë anëtarët e familjes për të drejtat dhe detyrat e tyre;
- Të informojë familjarët dhe të moshuarit mbi direktivat kryesore të politikave për mbrojtjen e të moshuarve;
- Të respektojë të drejta dhe detyrime të një individi në nevojë në një situatë të dhënë;
- Të respektojë parimin e autonomisë dhe të privatësisë gjatë përkujdesjes për individët në nevojë;
- Të zbatojë etikën profesionale të kujdestarit për të moshuar;
- Të zbatojë ligjshmërinë përkatëse të shërbimit social-shëndetësor për të moshuar;
- Të zbatojë parimet e garantimit të të drejtave të njeriut;

Komunikimi

- Të zbatojë rregullat specifike të komunikimit me individë të moshës së tretë;
- Të vëzhgojë ndryshimin e sjelljes së individit gjatë komunikimit;
- Të kontrollojë nivelin e shëndetit mendor dhe olistik nëpërmjet komunikimit;
- Të respektojë modelet e ndryshme kulturore dhe mënyrën sesi ato mund të ndikojnë në komunikim;
- Të përdorë teknikat e stimulimit të aftësive mendore dhe fizike;

- Të vëzhgojë prezencën e dyshimeve për keqtrajtim;
- Të raportojë rastet e dyshimeve për keqtrajtim;
- Të komunikojë me etikë profesionale me familjarët e individëve të moshuar;
- Të shmangë paragjykimet dhe keqkuptimet gjatë komunikimit me të moshuar;
- Të respektojë traditat, kulturën dhe zakonet krahinore të individëve të moshuar;
- Të shfaqë interes gjatë komunikimit me të moshuarin;
- Të përdorë metoda specifike për gjithëpërfshirjen e të moshuarve në aktivitete;
- Të përzgjedhë formën e duhur të komunikimit në lidhje me gjendjen specifike të të moshuarit;
- Të shfaqë interes për problemet sociale të të moshuarit me qëllim parandalimin e depresionit;
- Të informojë të moshuarin për kryerjen e procedurave shëndetësore;
- Të prezantojë saktë dhe në mënyrë profesionale shërbimit të klienti i moshuar;
- Të orientojë drejtë klientin e moshuar në rast pamundësie të ofrimit të një shërbimi të kërkuar;
- Të zbatojë metodat e intervistimit, dëgjimin dhe vëzhgimin duke pasur parasysh moshën e dhe gjendjen fizike të individit të asistuar;
- Të zbatojë mënyrën e paracaktuar të dokumentimit dhe raportimit të shkruar dhe gojor sipas rastit të dhënë;
- Të zbatojë hierarkinë dhe etikën profesionale me kolegë dhe eprorë;
- Të përdorë modelet e duhura të komunikimit në marrëdhëniet familjare, të gjeneratave të ndryshme dhe marrëdhëniet ndërkulturore;
- Të zbatojë parimet e përgjithshme të komunikimit ndërpersonal dhe ndërinstucional;
- Të zbatojë mënyrën e duhur të komunikimit me institucionet të tjera si, policia, shërbimi shëndetësorë, këshilltarët, psikologu apo njerëz të tjerë;
- Të përzgjedhë dhe vendosë forma të reja të komunikimit p.sh. përmes platformave dixhitale, duke siguruar që njerëzit mund të vazhdojnë të kenë akses të ri dhe mbështetje;
- Të mbështesë anëtarët e tjerë të familjes në periudhën para ose pas vdekjes së një anëtari të saj;
- Të komunikojë në mënyrë të përshtatshme për sigurimin e standardeve dhe ruajtjen e kufijve të nevojshëm sipas situatave;
- Të aplikojë parimet e konfidencialitetit dhe besueshmërisë;

Puna në grup

- Të përdorë teknikat e organizimit dhe lehtësimit të grupit;
- Të krijojë klimën e respektit dhe të mirëbesimit reciprok;
- Të ndërtojë marrëdhënie të ngrohta sociale;
- Të zbatojë teknikat e mobilizimit, vlerësimit dhe veprimit në grup;
- Të përzgjedhë teknikën e duhur në varësi të hapësirës dhe kohës në dispozicion;

- Të bashkëpunojë me koleget dhe familjarët e të moshuarve në zgjidhjen e problemeve të të moshuarit;
- Të përdorë metoda specifike për gjithëpërfshirjen e të moshuarve në aktivitete;
- Të përdorë teknika e menaxhimit të konflikteve që mund të lindin gjatë aktiviteteve;
- Të zbatojë parimet e punës në grup;

Ndihma e parë

- Të sigurojë veten nga kërcënimet e ambienti përreth përpara se të afrohet te individi që ka nevojë për ndihmë si p.sh ulja e automatit të energjisë elektrike, apo përdorimi i bombulave të monoksidit të karbonit në rast rënie të zjarrit,...
- Të zbatojë format dhe procedurat e ndihmës së parë;
- Të pozicionojë të dëmtuarit në pozicionin e përshtatshëm;
- Të vlerësojë gjendjen e komunikimit të të dëmtuarit;
- Të vlerësojë orientimin në kohë dhe hapësirë.
- Të vlerësojë frymëmarrjen e të dëmtuarit;
- Të identifikojë trupat e huaj në rrugët e frymëmarrjes;
- Të kontrollojë dhe lirojë rrugët e frymëmarrjes;
- Të kontrollojë ritmin dhe fortësinë e pulsit tek i dëmtuari;
- Të identifikojë simptomat e hipo/hiper tensionit;
- Të vlerësojë hemorragjinë e të dëmtuarit;
- Të vlerësojë deficietet motorike dhe neurologjike.
- Të vlerësojë ndjesinë e të vjellave;
- Të vlerësojë temperaturën trupore;
- Të sigurojë transportimin sa më të shpejtë dhe komod të të dëmtuarit;
- Të raportojë saktë gjendjen e të dëmtuarit tek ekipi i ambulancës ose urgjencës;
- Të japë ndihmën e parë në rast djegie;
- Të japë ndihmën e parë në rast helmimi;
- Të japë ndihmën e parë në gjendje të fikti;
- Të japë ndihmën e parë në fraktura;
- Të japë ndihmën e parë në rast hemorragjie;
- Të japë ndihmën e parë në rast pickimi nga gjarpëri;
- Të japë ndihmën e parë në rast ngecje ushqimi në rrugët e frymëmarrjes;
- Të realizojë masazh kardiak dhe frymëmarrje artificiale në rast nevojë;

Përkujdesja Sociale

- Të kryejë aktiviteteve edukative, rekreative dhe argëtuese;
- Të përdorë metoda dhe teknika të duhura për nxitjen e aftësisë së vlerësimit dhe vetë-vlerësimit të sukseseve dhe nevojave të të moshuarit;
- Të përgatisë dhe seleksionojë materiale, tregime, libra, muzikë ... të përshtatshme;
- Të dekorojë dhe zbukurojë ambiente, lokale sipas situatave;

- Të nxisë zhvillimin e autonomisë dhe shoqërizimit të të moshuarit;
- Të menaxhojë situatat e emergjencave dhe të krizës në punën në grup të të moshuarve;
- Të zbatojë politikat e mbrojtjes sociale në institucionet e shërbimit të kujdesit për të moshuar;
- Të zbatojë protokollet e duhura me një të moshuar që ka probleme me krimin, drogën, alkoolin, sipas rregullave të komunikimit për këtë rast;
- Të zbatojë protokollet e duhura me të moshuar që përjetojnë izolim, depresion, probleme me shëndetin apo kanë aftësi të kufizuara sipas rregullave të komunikimit për këtë rast;
- Të zbatojë protokollet e duhura me individë konfliktualë duke mos u bërë pjesë e konflikteve;
- Të zbatojë protokollet e duhura me të moshuarit me sëmundje dhe probleme të ndryshme;
- Të zbatojë protokollet e duhura me të moshuarit që kanë probleme me amnezinë apo demencën sikurse në rastin e Alzheimer.
- Të zbatojë protokollet e duhura me të moshuar paliativ për lehtësimin sado pak të vuajtjes nga sëmundja.
- Të respektojë privatësinë e të moshuarve;
- Të respektojë individualitetin e të moshuarve në mënyrën e arredimit të dhomës;
- Të inkurajojë të moshuarin në shprehjen e mendimeve dhe shprehjen e ndjenjave;

SHËRBIME TË KUJDESIT NË AKTIVITETET E JETËS SË PËRDITSHME

Ushqyerja

- Të vendosë dhe përgatisë të moshuarin në vendin ku do të marrë ushqimin kur është e nevojshme (për mëngjes, drekë,...etj.);
- Të respektojë dietën e ushqimore dhe të pijeve të konsumuara nga i moshuari;
- Të servirë ushqimin e përgatitur për të moshuarin;
- Të krijojë mundësinë që i moshuari të vetë-ushqehet;
- Të ushqejë të moshuarin në rast pamundësie totale të tij;
- Të vrojtojë vetëdijen dhe problemet gjatë gëlltitjes;
- Të pastrojë dhëmbët dhe gojën e të moshuarit;
- Të akomodojë të moshuarin në pozicionin e përshtatshëm;
- Të ajrosë dhe sistemojë dhomën;

Përkujdesja trupore

- Të përzgjedhë materialet dhe mjetet e duhura të punës;
- Të informojë të moshuarin për procedurat e përkujdesjes;
- Të përdorë saktë legenin e shtratit dhe oturakun;

- Të kryejë larjen dhe tharjen e flokëve, e fytyrës, gjymtyrëve të sipërme e të poshtme, të trungut dhe përkujdesjen intime;
- Të respektojë intimitetin e të moshuarve;

Dezinfektimi, sterilizimi

- Të dezinfektojë veshjet në rast sëmundjeje infektive duke zbatuar procedurat përkatëse;
- Të dezinfektojë mjetet e përdorura (legenin.....);
- Të kryejë dezinfektimin kimik me solucion dezinfektues duke respektuar procedurat e duhura;
- Të kryejë dezinfektimin kimik me rreze ultraviolele në laborator;
- Të kryejë dezinfektimin kimik nëpërmjet presionit të avujve të ujit për 30 minuta;
- Të kryejë dezinfektimin kimik me nxehtësi të thatë;
- Të kryejë dezinfektimin kimik me zierje për 20 minuta;
- Të kryejë dezinfektimin kimik me pasterizim duke zbatuar procedurat përkatëse;
- Të veshë dhe mbajë pastër uniformën e punës;

Masat parandaluese

- Të zbatojë masat parandaluese për TBC duke zbatuar procedurat përkatëse;
- Të zbatojë masat parandaluese për Hepatit duke zbatuar procedurat përkatëse;
- Të zbatojë masat parandaluese për AIDS duke zbatuar procedurat përkatëse;
- Të zbatojë masat parandaluese për raste pandemie duke zbatuar procedurat përkatëse;
- Të zbatojë masat parandaluese për sëmundjet infektive të lëkurës duke zbatuar procedurat përkatëse;
- Të bëjë trajtimin e kujdesshëm të materialeve septike dhe aseptike duke zbatuar procedurat përkatëse;
- Të kryejë punimin septik duke zbatuar procedurat përkatëse;
- Të bëjë trajtimin e veshjeve të pacientit dhe familjarëve sipas procedurës;
- Të bëjë trajtimin e mbeturinave pas punimit septik;

Shenjat vitale

- Të përzgjedhë instrumentet e duhura për të kryer matjen e pulsit dhe tensionit arterial;
- Të përzgjedhë instrumentin e duhur për matjen e oksimetrisë.
- Të analizojë me kujdes tabelën me parametrat normale të pulsit dhe tensionit arterial dhe frekuencën e frymëmarrjes sipas grup moshës;
- Të kryejë matjen e pulsit e të tensionit dhe të bëjë evidentimin e vlerave të matura në formularin përkatës;
- Të kryejë matjen e frekuencës respiratore dhe oksimetrinë dhe të bëjë evidentimin e vlerave të matura në formularin përkatës;
- Të kryejë matjen e temperaturës në mënyra të ndryshme dhe të bëjë evidentimin e vlerave të matura;

- Të kryejë veprimet e duhura për uljen e temperaturës;
- Të përmbushë këshillat dhe udhëzimet mjekësore dhe të bëjë evidentimin;
- Të kryejë veprimet e duhura në rast efektesh anësore të medikamenteve;
- Të sqarojë të moshuarin në rast paqartësie dhe mëdysheje;
- Të kryejë identifikimin e efekteve të pa dëshiruara të procedurave të rekomanduara;

Perkujdesje geriartrike

- Të kryejë gjimnastikën shëruese për rivendosjen e funksioneve të aparatit të lëvizor dhe të sistemit vegetativ tek të moshuarit në nevojë social-shëndetësore;
- Të ofrojë kujdes në lidhje me higjienën intime, personale dhe rehatinë e një të moshuari;
- Të kryejë zhveshjen dhe veshjen e individëve në nevojë social-shëndetësore;
- Të bëjë një larje/dush një të moshuari si: (pastrim/larje fytyre, hundë, dhëmbët, kujdesi për veshët, organet gjenitale, etj.);
- Të vëzhgojë oreksin, ngopjen, tolerancën e tretjes së ushqimit tek i moshuari;
- Të pastrojë dhe dezinfektojë materiale të ndryshme që lidhen me ushqimin;
- Të ofrojë kujdes në lidhje me jashtëqitjen e të moshuarit kur është e nevojshme;
- Të ndërrojë pampersin e një të moshuari, kur është e nevojshme;
- Të ndihmojë të moshuarin, kur është e nevojshme, gjatë kohës së tualetit, fazave të ndryshme që lidhen me mbajtjen e pastërtisë;
- Të pastrojë dhe dezinfektojë materiale të ndryshme që lidhen me jashtëqitjen;
- Të përgatisë dhomën apo vendin e pushimit;
- Të krijojë kushte të favorshme për të rënë në gjumë dhe të monitorojë cilësinë e gjumit dhe pagjumësinë së një të moshuari;
- Të vëzhgojë gjendjen e përgjithshme të të moshuarit (pamjen, pastërtinë, shkallën e mobilitetit, ndërjegjësimi, hidratimit), autonominë dhe sjelljen;
- Të vëzhgojë ngjyrën, integritetin, thatësinë, ngrohtësinë/temperaturën, butësinë e lëkurës;
- Të evidentojë shenjat patologjike: edemë, plagë, skuqje, irritime, hemorragji, hematoma, etj.;
- Të identifikojë shenjat e dhimbjeve të ndryshme të një të moshuari;
- Të respektojë këshillat për menaxhimin e dhimbjes;
- Të monitorojë pikat mbështetëse në shtrat të të moshuarit për të evituar dekubitueset;
- Të respektojë reagimet e një individi, nivelin e komunikimit, gjendjen e stresit, emocionin, qëndrueshmërinë, gjuhën (të folurën), orientimin në kohë-hapësirë, etj.;
- Të identifikojë shenja të abuzimit;
- Të respektojë dhe të masë shenjat vitale: temperaturën, pulsën, frekuencën respiratore dhe presionin arterial, peshën...;
- Të monitorojë rrugët urinare, të zorrëve, çrregullimet e tretjes apo të vjella të mundshme;

- Të vëzhgojë mirëfunksionimin e pajisjeve dhe mjeteve mjekësore;
- Të kujdeset për parapërgatitjet gjatë një vizite mjekësore, analize apo ndërhyrje kirurgjikale;
- Të monitorojë një të moshuar të sëmurë që është duke marrë infuzion, mjekim tjetër apo që ka bërë një ndërhyrje kirurgjikale;
- Të monitorojë të moshuarin që është duke marrë një infuzion, oksigjen ose që është duke përdorur pajisje të tjera mjekësore;
- Të monitorojë të moshuarin pas terapisë me jod radioaktiv ose pas kimioterapisë;
- Të sigurojë pajisjet apo mjetet që do të përdoren duke ndihmuar mjekun apo infermierin për procesin që do të kryhet (garzë, produktet ...);
- Të ndihmojë infermierin, gjatë zgjimit të parë mbas një ndërhyrje ose fizioterapie të një të operuari;
- Të përgatisë dhe instalojë një aparat aerosol;
- Të ndihmojë gjatë marrjes së një mjekimi (barnash);
- Të respektojë reagimet e individit;
- Të identifikojë raste të hipertermisë apo hipotermisë dhe të ndihmojë në rregullimin e temperaturës;
- Të vrojtojë dhe monitorojë rastet e humbjes së peshës (shkaqet, ndikim sëmundje, pasojat ...) dhe të bëjë informimet e duhura te personat përgjegjës;
- Të identifikojë dhe të zbulojë praninë e dëmtuesve (parazitëve, p.sh. morra...) dhe të ndër marrë veprimet e duhura për të luftuar kundër tyre;
- Të kujdeset për individë me çrregullime të frymëmarrjes dhe sëmundje kardiovaskulare;
- Të kujdeset për individë me çrregullime dhe sëmundje të aparatit gastrointestinal dhe urogenital;
- Të kujdeset për individë me çrregullime dhe sëmundje të aparatit muskuloskeletik;
- Të kujdeset për individë me çrregullime dhe sëmundje infektive duke zbatuar rregullat përkatëse të shërbimit;
- Të kujdeset për individë me çrregullime të dëgjimit, shikimit dhe neuropsikiatrike duke përdorur teknikat përkatëse të shërbimit;
- Të kujdeset për individë me deficite motorike dhe disabilitet nga sëmundje neurologjike degjenerative;
- Të kujdeset për individë me probleme nga sëmundje onkologjike që u nevojitet kujdes paliativ;
- Të kujdeset për trupin e të moshuarit që humb jetën;
- Të ndihmojë në mundësimin e një shërbimi funeral në institucionet shëndetësore;

Sigurimi dhe mirëmbajtja e ambientit të përshtatshëm në varësi të moshës, autonomisë, të ndonjë sëmundjeje ose paaftësie;

- Të pastrojë, dezinfektojë të gjitha pajisjet dhe mobileje e përshtatshme;
- Të zhvillojë hapësirën në varësi të nevojave të individit, pajisjeve dhe mobileve;

- Të evakujë veshjet e përdorura apo pajisjet e papastra;
- Të përgatisë shtretërit apo ambientet e tjera të gjumit;
- Të hedhë mbeturinat në enë të përshtatshme dhe në vendin e duhur;
- Të instalojë dhe të mbajë pastër pajisjet e ndryshme shumë përdorimshe brenda shërbimit;
- Të kujdeset gjatë përdorimit të karrocave, të karrigeve me rrota;
- Të kontrollojë afatet e skadimit të pajisjeve, mjeteve apo materialeve të tjera;
- Të kujdeset për të moshuarin në një shëtitje;
- Të kujdeset për të moshuarin në ambiente me nivel më të lartë rrezikshmërie për ta;
- Të japë ndihmën e duhur teknike sipas rasteve, në përdorimin e aparateve apo pajisjeve të përdorimit të përditshëm (syze, aparate dëgjimi ...);

Sipërmarrja

- Të demonstrojë aftësi për të zhvilluar një projekt ide sipërmarrëse (për të zhvilluar dhe zbatuar një buxhet të caktuar);
- Të përdorë metoda dhe teknika të ndryshme të zbatimit të një projekti;
- Të analizojë të dhëna për të marrë vendimet e duhura në kontekste të ndryshme;
- Të identifikojë dhe të zgjidhë problem në mënyrë krijuese;
- Të negociojë ide me të tjerët në mënyrë efektive;
- Të demonstrojë aftësi për të njohur dhe vlerësuar risqet;
- Të demonstrojë aftësi për të planifikuar, bërë, kontrolluar dhe vepruar me qëllim për t'u vetë-përmirësuar;
- Të vlerësojë potencialin personal (aftësitë personale, sociale dhe për biznes, njohuritë e mëparshme..) për të shfrytëzuar avantazhin konkurrues;
- Të demonstrojë aftësi udhëheqëse në situata të ndryshme;
- Të demonstrojë aftësi për të aplikuar parimet e ekonomisë së lirë të tregut në situata të ndryshme;
- Të demonstrojë aftësi për të motivuar dhe inkurajuar të tjerët në arritjen e synimeve të tyre;
- Të aplikojë aftësitë për planifikim dhe menaxhim projekti në situata të ndryshme;
- Të sigurojë burime e duhura dhe të marrë përgjegjësinë për t'u kujdesuar për to;
- Të demonstrojë aftësi të mira marketingu;
- Të sigurojë një performancë sipas standardeve të shërbimit;
- Të menaxhojë stafin profesional, duke promovuar talentet dhe zhvillimin e mundësive të karrierës;
- Të hartojë një plan efektiv biznesi sipas profilit përkatës;

TIK

- Të përdorë programin (softuare) e planifikimit të kujdesit në shërbimin e kujdesit për të moshuar;

- Të përdorë programin (softuare) e dokumentimit të kujdesit në shërbimin e kujdesit për të moshuar;
- Të përdorë programin (softuare) e regjistrimit dhe raportimit të rezultateve të kujdesit për të moshuar;
- Të përdorë programin (softuare) e planifikimit të kohës së shërbimit, pozicionit dhe vendeve të punës së personelit në shërbimin e kujdesit për të moshuar;
- Të përdorë programin (softuare) e të dhënat sociale dhe shëndetësore të të moshuarve;
- Të përdorë programin (softuare) e administrimit ekonomik të të moshuarve;
- Të përdorë programe apo aplikacione për informacione ndaj kujdesit të shëndetit.
- Të përdorë network-un e shërbimit të kujdesit për të moshuar;
- Të asistojë të moshuar gjatë përdorimit të teknologjisë së informacionit dhe komunikimit;
- Të përdorë programe ose aplikacione që ndihmojnë në kujdesin shëndetësor të ofruar;

Siguria në punë dhe mbrojtja e mjedisit

- Të zbatojë politikat ambientale për ruajtjen e mjedisit;
- Të shmangë faktorët ndikues në ndotjen e ambientit;
- Të zbatojë kërkesat e legjislacionit për mbrojtjen e ambientit;
- Të diferencojë llojet e mbetjeve në urbane apo spitalore;
- Të zbatojë udhëzimet për mbrojtjen ndaj mbetjeve të kontaminuara me lëndë kimike apo biologjike dhe trajtimin e tyre;
- Të zbatojë protokollet për trajtimin e mbetjeve spitalore ose urbane;
- Të kryejë ndarjen e mbetjeve në burim sipas informacioneve të dhëna;
- Të përzgjedhë detergjente ose lëndë dezinfektuese të duhura për ambientin ku zhvillojnë aktivitetin e tyre ditor;
- Të vendosë në kontejnerë të posaçëm mbeturina që përbëhen nga mjete prerëse.

KOMPETENCA TE PERGJITHSHME

Nxënësi duhet të jetë i aftë:

- Të komunikojë në mënyrë korrekte me shkrim e me gojë për të shprehur mendimet e ndjenjat e tij dhe për të argumentuar opinionet për çështje të ndryshme.
- Të përdorë burime dhe teknika të ndryshme të mbledhjes dhe të shfrytëzimit të informacioneve të nevojshme për zhvillimin e tij personal dhe profesional.
- Të nxisë potencialin e tij të brendshëm, në kërkim të vazhdueshëm për zgjidhje të reja më efektive dhe më eficientë.
- Të angazhohet fizikisht, mendërisht dhe emocionalisht në kryerjen e detyrave të ndryshme në kontekstin profesional, personal dhe shoqëror.
- Të ruajë etikën dhe respektin ndaj personave me të cilët bashkëpunon.
- Të ruajë etikën dhe sjelljen me personat për të cilët kujdeset.

- Të respektojë rregullat dhe parimet e një bashkëjetese demokratike në kontekstin e integriteteve lokale, rajonale.
- Të manifestojë guxim dhe aftësi sipërmarrëse për të ardhmen e tij.
- Të tregojë vetëkontroll gjatë ushtrimit të veprimtarive të tij.
- Ta dojë punën që bën.
- Të ketë vullnet për punën që angazhohet.
- Të organizojë drejt, procesin e të nxënës të tij dhe të shfaqë gatishmërinë dhe vullnetin për të nxënë gjatë gjithë jetës.
- Të respektojë parimet e punës në grup dhe të bashkëpunojë aktivisht në arritjen e objektivave të pranuar.
- Të vlerësojë dhe vetë vlerësojë nisur nga kritere të drejta si bazë për të përmirësuar dhe çuar më tej arritjet e tij.
- Të demonstrojë aftësi për të përmbushur detyrat brenda afateve sipas një plani të caktuar;
- Të marrë nisma për të bashkëpunuar me individë apo grupe;
- Të demonstrojë sjellje të përgjegjshme dhe etike në veprimtari shkollore dhe komunitet;
- Të demonstrojë aftësi për të punuar në mënyrë të pavarur dhe për qenë pjesëmarrës pro aktiv në grup;
- Të demonstrojë përgjegjshmëri ndaj mjedisit dhe të mirave publike;
- Të pranojë dhe të promovojë risitë dhe ndryshimet;
- Të demonstrojë marrjen e nismave për të zhvilluar dhe zbatuar një ide;
- Të demonstrojë zotësi për të nxënë nga dështimet dhe për të këmbëngulur drejt arritjes së synimeve të tij/saj;
- Të aplikojë mënyra konstruktive të përgjigjeve ndaj kritikave.
- Të jetë i aftë të bëjë vetëvlerësimin e tij sipas kapaciteteve që ofron.